



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI KOMBËTAR PËR
SIGURINË KIBERNETIKE

Tiranë më, 15.07.2024
Nr. 617 prot.

SHOQËRIA "ALBPETROL" SHA

Patos më, 15.07.2024
Nr. 4258 prot.

MARRËVESHJE KONFIDENCIALITETI

Sot, më datë 15.07.2024, lidhet kjo Marrëveshje Kofidencialiteti ndërmjet palëve:

Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (në vijim "AKSK"), me adresë "Rruga Papa Gjon Pali II", përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Igli Tafa, dhe

Dhe

Shoqërisë ALBPETROL SH.A., Patos person juridik me numër identifikimi (NUIS) J82916500U, me Seli Rruga Fier-Patos Km. 7, Patos, Lagja "29 Marsi" Patos, numër kontakti (+355) 3813662, e-mail: info@albpetrol.al; përfaqësuar nga Administratori Z. Eltar Deda ,

Referuar në vijim si "*Palët*"

Duke pranuar se Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit (TIK) kanë hapur dritare të reja mundësish dhe janë mjete thelbësore për zhvillimin socio-ekonomik të shteteve;

Duke pranuar se TIK kanë sjellë gjithashtu lloje të reja kërcënimesh si: krimi kibernetik, spiunazhi kibernetik, aktivizimi, terrorizmi kibernetik, lufta kibernetike, sulmet ndaj infrastrukturës kritike, fushat e dezinformimit; dhe se këto kërcënime janë në rritje globalisht, ndërkombëtarisht, në mënyrë dinamike dhe po shfaqen gjithnjë e më të sofistikuar;

Palët kanë interesa strategjike të përbashkëta dhe bien dakord të bashkëpunojnë në fushën e informacionit bazuar në përfitime të njëjta dhe reciproke, për të përmirësuar bashkëpunimin në përgjigje të incidenteve të sigurisë së informacionit.

Duke pranuar rolin e Palëve në fushën e sigurisë kibernetike, në zbatimin e politikave dhe reagimeve operacionale, zhvillimin e mjeteve dhe në kuadrin rregullator.

Palët synojnë të përcaktojnë qëllimet kryesore, objektivat, fushat dhe format e bashkëpunimit, të përfshira në këtë Marrëveshje Konfidencialiteti për sa vijon.

Neni 1 QËLLIMI

Kjo Marrëveshje Konfidencialiteti ka për qëllim të promovojë bashkëpunimin në fushën e sigurisë kibernetike ndërmjet Palëve si dhe të përmirësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet palëve në lidhje me sigurinë kibernetike bazuar në specifikimet sipas Nenit 4 të kësaj Marrëveshje Konfidencialiteti.

Neni 2 STATUSI DHE FUSHA E MARRËVESHJES SË KONFIDENCIALITETIT

1. Kjo Marrëveshje Konfidencialiteti përcakton kornizën brenda të cilës Palët synojnë të bashkëpunojnë për të arritur qëllimet e përcaktuara në nenin 1.
2. Kjo Marrëveshje Konfidencialiteti nuk ka për qëllim të krijojë, mbajë ose imponojë të drejta dhe detyrime ligjore ndaj Palëve ose ndërmjet Palëve të treta. Zbatimi i kësaj Marrëveshje Konfidencialiteti nga Palët e përcaktuara në të, i nënshtrohet përcaktimeve ligjore në fuqi.

Neni 3 FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

- 1.
2. Për të arritur qëllimin e mësipërm të kësaj Marrëveshje Konfidencialiteti, Palët synojnë të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:
 - a) Vendosjen në dispozicion të kopjes së logeve;
 - b) Ndarjen e informacionit në lidhje me përhapjen e programeve keqdashëse;
 - c) Shkëmbimin e indikatorëve të kompromisit;
 - d) Ofrimin e informacionit për zgjidhjet e mundshme në fushën e sigurisë së informacionit;
 - e) Shkëmbimin e materialeve edukative dhe trajnuese lidhur me sigurinë kibernetike;
 - f) Bashkëpunimin dhe koordinimin e ndërsjellë në lidhje me zhvillimin e seminareve teknike, edukative dhe trajnimeve;
 - g) Ofrimin e asistencës informative këshilluese në parandalimin dhe trajtimin e incidenteve të sigurisë së informacionit;
 - h) Shkëmbimin e informacionit mbi rreziqet e sigurisë së informacionit;

Neni 4 SHKËMBIMI DHE PËRDORIMI INFORMACIONIT

1. Palët marrin përsipër të shkëmbejnë informacionin për qëllimet e kësaj Marrëveshje duke ruajtur Konfidencialitetin. Shkëmbimi i informacionit sipas kushteve të kësaj

Marrëveshje Konfidencialiteti, do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, politikat dhe mekanizmat në fuqi të palëve.

2. Asnjëra palë nuk do të shpërndajë informacionet e marra nga Pala tjetër sipas përcaktimeve të kësaj Marrëveshje Konfidencialiteti, asnjë palë të tretë pa pëlqimin paraprak të Palës tjetër.

4. Palët do të zbatojnë mbrojtjen e të dhënave personale, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

5. Palët do të caktojnë një person kontakti përgjegjës për komunikimet ndërmjet Palëve në kuadrin e kësaj marrëveshjeje.

6. Çdo aktivitet i përbashkët që përfshin pronësinë intelektuale do të dakordësohet me shkrim nga Palët për të mbrojtur interesat përkatëse.

Neni 5

ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES SË KONFIDENCIALITETIT

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Marrëveshje Konfidencialiteti do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet konsultimeve dhe/ose negociatave ndërmjet palëve.

Neni 6

FILLIMI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

1. Kjo Marrëveshje Konfidencialiteti hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët.

2. Kjo Marrëveshje Konfidencialiteti nënshkruhet për një afat të pacaktuar dhe Palët mund ta ndërpresin atë në çdo kohë duke njoftuar 30 (tridhjetë) ditë para palën tjetër me shkrim. Ndërprerja e marrëveshjes nuk përjashton palët nga detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit të informacioneve të shkëmbyera në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

3. Aktivitetet që janë në proces në momentin e përfundimit të marrëveshjes, do të përfundojnë në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

4. Kjo Marrëveshje Konfidencialiteti mund të modifikohet me marrëveshje reciproke me shkrim të Palëve.

5. Një modifikim i kësaj marrëveshjeje do të hyjë në fuqi në datën e përcaktuar reciprokisht nga Palët.

Neni 7

KOSTOT, SHPENZIMET DHE BURIME

Çdo Palë merr përsipër shpenzimet e veta personale dhe i siguron vetes burime për ekzekutimin e kësaj marrëveshje dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të. Të gjitha aktivitetet sipas kësaj Marrëveshje Konfidencialiteti, do t'i nënshtrohen disponueshmërisë së burimeve financiare dhe njerëzore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8
INFORMACIONET E KONTAKTIT

AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE	ALBPETROL
Emër: Emis Arifi	Emër: Thanas Dinaku
Institucioni: AKSK	Institucioni: Albpetrol Sh.a
Telefon: +355 4 22 210 39	Telefon: +355676066667
Adresë e-mail: emis.arifi@cesk.gov.al	Adresë e-mail: it@albp petrol.al
Telefon 24/7: +355 4 22 210 39	Telefon 24/7: +355676066667
Telefon emergjencash: +355 67386 4542	Telefon emergjencash: +355676066667
Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Tiranë, Shqipëri	Adresa: Rr Fier-Patos Km.7, Patos, Lagja "29 Marsi" Patos

Neni 9
NËNSHKRIMI

Marrëveshja e Konfidencialitetit nënshkruhet nga përfaqësuesit e mëposhtëm të palëve:

**AUTORITETI KOMBËTAR PËR
SIGURINË KIBERNETIKE**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

ADMINISTRATOR

Eltar DEDA

